



Numri ynë: _____

Shkup

Në bazë të Nenit 50, paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 05/02), dhe në lidhje me Nenin 19 dhe Nenin 23 paragrafi 4 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 38/96, 9/97, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/16, 64/18 dhe 35/19 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 275/19, 89/22 dhe 274/22), dhe në përputhje me Vendimin për shpalljen e konkursit publik për zgjedhjen e Drejtorit nr. 08-8857/1 të datës 05.08.2024, Kryetarja e Qytetit të Shkupit, shpall:

KONKURS PUBLIK
për zgjedhjen e drejtorit të Ndërmarrjes Publike
"Ujësjetësi dhe Kanalizimi" - Shkup

1. Kandidati për zgjedhjen e drejtorit duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- të jetë nënshkruar në Republikën e Maqedonisë;
- të posedojnë së paku 240 kredi sipas EKTS ose të kenë përfunduar nivelin VII/1 të arsimit;
- në momentin e emërimit, me vendim gjyqësor të formës së prerë të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtjeje për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- të ketë së paku pesë vite përvojë pune;
- të posedojnë një nga certifikatat e pranuar ndërkombëtare ose të vërtetimeve për njohje aktive të gjuhës angleze, jo më të vjetra se pesë vite, si vijon: TOEFEL IBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2, FCE Cambridge English: First) provimi i dhënë ose BULATS – së paku 60 pikë, ose APTIS – së paku niveli B2.

2. Kandidati për drejtor përveç dëshmimeve për përmbushjen e kushteve të lartpërmendura duhet të depozitojë edhe:

- aplikim me biografi të shkurtër;
- propozim program për punën dhe zhvillimin e ndërmarrjes.

3. Dokumentacionin e nevojshëm, kandidati është i detyruar ta depozitojë në origjinal ose kopje të verifikuar te noteri.

4. Afati për depozitimin e dokumentacionit të nevojshëm është 10 ditë nga dita e shpalljes së konkursit publik në shtypin ditor.

5. Aplikimet depozitohen pranë te Arkivit të Qytetit të Shkupit ose nëpërmjet postës në adresën bul. "Ilinden" nr.82- Shkup në mënyrë të detyrueshme me shënimin – Për konkursin publik për zgjedhjen e drejtorit të NP "Ujësjellësi dhe Kanalizimi" – Shkup.

6. Drejtori zgjidhet me mandat 4 vjeçar.

7. Dokumentacioni i depozituar me vonesë nuk do të shqyrtohet.

Kryetarja e Qytetit të Shkupit

Danela Arsovska

